



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit, dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykues II

Gjykatës Çarls L. Smith III, kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 5 gusht 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Zgjatje Afati për Përgjigje ndaj
Parashtrimit të Protokolluar F02478**

Prokurores së Specializuar
Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Lluka Mishetiç

Mbrojtësit të Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagendra

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykses"), në bazë të neneve 21(4)(c) dhe 40(2) të Ligjit Nr. 05/L 053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullës 9(5)(a) të Rregullores së Procedurës dhe Provave përpara Dhomave të Specializuara ("Rregullorja"), merr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 30 korrik 2024, ekipet e mbrojtjes së Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit, dhe Jakup Krasniqit (bashkërisht, "Mbrojtja") dorëzuan mocion ku kërkonin përjashtimin e provave të W01234-ës, W04859-ës, W04860-s dhe W04570-s ("Mocioni i Mbrojtjes").¹
2. Më 31 korrik 2024, Zyra e Prokurores së Specializuar ("ZPS") dorëzoi kërkesë për zgjatje afati për t'iu përgjigjur Mocionit të Mbrojtjes ("Kërkesa").²
3. Mbrojtja njoftoi se nuk do t'i përgjigjej Kërkesës.³

II. PARASHTRIME

4. ZPS-ja kërkon zgjatje afati me shtatëmbëdhjetë (17) ditë për t'iu përgjigjur Mocionit të Mbrojtjes, deri të hënën, 26 gusht 2024.⁴ ZPS-ja parashtron se Kërkesa është në kohë, e arsyeshme dhe proporcionale.⁵ Ajo argumenton se ekzistojnë arsye të vlefshme për të miratuar zgjatjen e kërkuar, duke theksuar fushëveprimin dhe pasojat e Mocionit dhe numrin më të kufizuar të personelit gjatë pushimit të Gjykatës. Së fundi, ZPS-ja parashtron se zgjatja e afatit nuk i shkakton asnjë dëm Mbrojtjes.⁶

¹ F02478, Mbrojtësi e Specializuar, *Mocion i Përbashkët i Mbrojtjes për Përjashtimin e Provave të W01234-ës, W04859-ës, W04860-ës dhe W04570-ës*, 30 korrik 2024, konfidencial.

² F02481, Prokurorja e Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Zgjatje Afati për Përgjigje ndaj Parashtrimit të Protokolluar F02478*, 31 korrik 2024.

³ Korrespondenca CRSPD547.

⁴ Kërkesa, para. 1.

⁵ Kërkesa, para. 1.

⁶ Kërkesa, para. 2.

III. DISPOZITA LIGJORE PËRKATËSE

5. Në pajtim me rregullën 9(5)(a) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mund të zgjasë, *proprio motu* ose kur i tregohen arsye të vlefshme, çdo afat të përcaktuar prej Rregullores ose prej Panelit.

IV. DISKUTIM

6. Trupi Gjykues konstaton se Kërkesa është paraqitur në kohë pasi është dorëzuar në kohë të mjaftueshme para përfundimit të afatit përkatës.

7. Trupi Gjykues gjithashtu konstaton se ZPS-ja ka treguar se ekzistojnë arsye të vlefshme për zgjatje të kufizuar kohe, duke mbajtur parasysh në veçanti: (i) fushëveprimin dhe pasojat e Mocionit të Mbrojtjes; (ii) rëndësinë e dëshmitarëve relevantë; dhe (iii) numrin e pakësuar të personelit gjatë pushimeve të gjykatës. Trupi Gjykues po ashtu merr parasysh që Mbrojtja nuk e kundërshtoi Kërkesën.⁷ Trupi Gjykues po ashtu vlerëson se zgjatja e afatit të kërkuar prej ZPS-së është e arsyeshme dhe proporcionale në këto rrethana.

8. Duke mbajtur parasysh sa më lart, Trupi Gjykues zgjat afatin për ZPS-në për t'iu përgjigjur Mocionit të Mbrojtjes deri **të hënën, 26 gusht 2024**.

⁷ *Shih* Mocionin e Mbrojtjes, para. 35; Korrespondenca CRSPD547.

V. VENDIM

9. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykues:

- a) **MIRATON** Kërkesën e ZPS-së; dhe
- b) **ZGJAT** afatin për ZPS-në për t'iu përgjigjur Mocionit të Mbrojtjes deri të hënën, 26 gusht 2024.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E hënë, 5 gusht 2024

Në Hagë, Holandë